33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimi të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-24-11422-5-1-1/C1038

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj . Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve do të jetë brenda 24 muajve, sipas urdhërësës së menaxherit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Ekipa për Menaxhimin e Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 13 muaj .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Ri-projektimi i rregullimit të shtratit të lumit Llukac - Segmenti I, Gjakove
Lumi
Paramasa dhe Parallogaria Aksi 1
Segmenti i pa realizuar: L = 0+152.23 km, B = 14.00 m, b = 3.00 m
Segmenti i realizuar: st 0+152.23 km - 0+755.00 km, b=3.00 m

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët Pregaditore				
1	Punët përgaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtes me zyre (zyrja të ketë hapësirë edhe për tavolina punë-takimeve për organin mbikëqyrës dhe projekt menaxherin, internet dhe paisjet e nevojshme për SSHP) dhe shenjat e nevojshme për siguri dhe paralajmërim të vendpunishtes.	komplet	1,00	9.878,00	9.878,00 €
2	Pastrimi i terrenit, prerja e shkurreve në të dy anet e lumit dhe në shtrat të lumit, largimi i mbeturinave të ndryshme nga shtrati i lumit dhe bartja e mbetjeve në deponi të posaçme të caktuar nga Investitori në largësi deri në 15 km	m'	755,00	15,00	11.325,00 €
3	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet	m'	755,00	1,50	1.132,50 €
4	Demolimi dhe rivendosja e rrethojave të ndryshme në skajet e lumit, si rrethoja metalike, nga druri dhe tel gëmbor.	m'	50,00	20,00	1.000,00 €
5	Largimi i shtyllave ekzistuese nga druri dhe zevendesimi i tyre me shtylla të betonit me lartësi H=9m këndore tip 40°, me bazament të betonit duke përfshirë germimin për bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazës, vendosja e konzollës (për rrjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nese ekziston) si dhe demontimi dhe emontimi i serishem i kabllove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar.	copë	3,00	300,00	900,00 €

KOMISIONI I VLERËSIMIT - 10.12.2024

1. P.F. - *[Signature]*

2. P.M. - *[Signature]*

3. L.O. - *[Signature]*

6	Zhvendosja e shtyllave ekzistuese nga betoni, me bazament te betonit duke perfshire germimin per bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm (3.5mm), reren e imet, montimin e unazes, vendosja e konzolles (per rrjet ajror 0.4kV), trupave ndriqes (nese ekziston) si dhe demontimi dhe montimi i serishem i kablllove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshem komplet me ateste per një shtylle te dislokuar.	copë	3,00	350,00	1.050,00 €
7	Ngritja e kapakeve metalik te pusetave te instalimeve nëntokësore. Në këtë pozicion përfshihet edhe punimi i kokave nga betoni i armuar dhe rivendosja e kapakut nga materiali i gizës apo materiali kompozit të klasës C250 sipas EN 124 për pesha të mesme deri në 25 ton.	copë	12,00	145,00	1.740,00 €
8	Devijimi i ujit të lumit gjatë realizimit të punëve në shtratin e lumit.	m'	755,00	25,00	18.875,00 €
9	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (nese projekti ka ndryshime gjate ekzekutimit).	m'	755,00	1,50	1.132,50 €
Gjithsej totali me TVSH					47.033,00 €
II	Punët e Gërmimit				
1	Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne fundin dhe brigjet e lumit si dhe hapja e themeleve për muret mbrojtëse, trotualet, gërmimi për sanimet e shtratit dhe themelet në vendet ku është e nevojshme. Materiali i gërmuar duhet të kasifikohet dhe i njafti mund të përdoret për rregullimin e brigjeve të lumit dhe mbushjen e skarpateve, ndërsa pjesa e mbetur, së bashku me materialin humosor dhe me permbajtje të lartë të materieve organike, duhet të bartet në deponi të përshtatshme në largësi deri në 15 km.	m³	8.613,41	4,50	38.760,35 €
2	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV dhe pastrimi i shtratit të lumit nën ura, (ura në rr. Petro Nini Luarasi dhe ura në rr. Gasper Karaqi).	m²	800,00	13,00	10.400,00 €
Gjithsej totali me TVSH					49.160,35 €
III	Punët e Objekteve				
1	Mveshja e lumit me gurë dhe rregullimi i skarpateve				
1.1.	Furnizimi dhe vendosja e gurëve natyrore të minuar për rregullimin e brigjeve të lumit të vendosen sipas pozitës së paraparë në projekt. Gurët duhet të kenë diametër rreth d=1.0m. Në llogari është përfshirë edhe gërmimi i skarpateve ekzistuese për vendosjen e gurëve dhe rregullimi i hapësirës pas përfundimit të këtij pozicioni.	m²	992,50	50,00	49.625,00 €

1. P.F. - *[Signature]*
2. P.M. - *[Signature]*
3. L.O. - *[Signature]*

MAJ
BEI
297
AKO

1,2	Furnizimi dhe vendosja e gurëve natyrore me trashësi tmes=20cm në skarpate të lumit dhe bazë të lumit me gjatësi sipas profileve karakteristike (të ngjashëm me gurët ekzistues) për stacionazhat P10 - P11 dhe P28 - P29. Vendosja e gurëve bëhet me beton C-25/30, t=20 cm (duke e llogaritur edhe një rrjetë armatur Q-335). Materiali lidhës për mbushjen e fugave duhet të jetë llaç çimentoje, fugat të percillen në madhesi të atyre ekzistuese.	m ²	142,66	60,00	8.559,60 €
1,3	Punimi i mbushjeve në brigjet (argjinaturave) dhe fundet e lumit, sipas niveleve dhe formes së parapara me projekt. Mbushja bëhet me materiale rrethimore më parë të klasifikuara nga gërmimi. Mbushja bëhet në shtresa maksimum 30 cm të cilat duhet të ngjeshen deri në kompaktësimin e nevojshëm. Në këtë pozicion përfshihet edhe mbushja e terenit prapa mureve mbrojtëse si sjellja e materialit nga huaza, në rast se materiali i gërmuar nuk është klasifikuar si duhet dhe përmban mbetje organike në sasi të madhe.	m ³	1.580,00	13,00	20.540,00 €
2	Punimi i Mureve mbrojtëse				
2.1.	Furnizimi, prerja formësimi dhe vendosja e armaturës së brinjezuar S400/500 profile Ø8 mm, Ø10 mm, Ø12 mm dhe Ø16 mm	kg	52.904,01	1,00	52.904,01 €
2.2.	Furnizimi, dhe vendosja e armatures rrjetë Q355 (Ø8 15x15cm) në pllakën e shtegut. Në këtë pozicion duhet të llogaritet edhe palimi i rrieteve.	kg	2.424,86	2,00	4.849,72 €
2,3	Furnizimi dhe vendosja ne veper e betonit C-30/37 jo ujë-përshkrushëm për betonimin e mureve mbrojtëse së bashku me themele, duke e llogaritur edhe kallupimin. Muret kanë lartësi mesatare h= 4.0 m dhe trashësi t=0.30 - 0.60 m dhe themele me dimensione b/h=2.40/0.80 m.	m ³	1.183,30	135,00	159.745,50 €
2,4	Furnizimi dhe lyerja e mureve mbrojtëse në pjesët ku kanë kontakt me dhe me material hidroizoluese (jo ujëpërshkuese).	m ²	1.716,25	1,50	2.574,38 €
2,5	Furnizimi me material me bazë silikon transparent (materiali Antipruiol-Mapei ose i ngjasëm) për lyerjen e mureve me strukturë në pjeset e dukshme në të dy anet dhe në pjesen e sipërme. Lyerja preferohet të bëhet duke aplikuar solucioin me spërkatje deri në mbulimin e plotë të sipërfaqeve. Sipërfaqja paraprakisht duhet të pastrohet mire nga pluhuri dhe papastërtitë tjera.	m ²	1.271,30	2,50	3.178,25 €
Gjithsej totali me TVSH					301.976,46 €
IV	Punët e Zhavorit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktësimi i materialit gurorë 50-150mm për sanimin e nënbazës së themeleve.	m ³	101,35	15,00	1.520,25 €

1. P.F. - *[Signature]*
2. P.M. - *[Signature]*
3. L.O. - *[Signature]*

2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushës 0-150 mm tmes t=15 cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. nën shtresën 0-31 mm për trotuare.	m³	596,25	10,00	5.962,50 €
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë te trotuaret Mv>80 MPa).	m³	485,62	13,00	6.313,06 €
4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63mm, t=25cm nën bazën e themeleve të mureve mbrojtëse. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>40 Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit për rregullimi i hapësirës përreth lumit.	m³	465,23	12,00	5.582,76 €
5	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit drenazhues prapa mureve mbrojtëse.	m³	371,34	15,00	5.570,10 €
6	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (material shterp nga gurthuesit) për punimin e bankinave	m³	132,28	15,00	1.984,20 €
Gjithsej totali me TVSH					26.932,87 €
V	Punët e Betonit				
1	Punët e kaskadave				
1	Furnizimi me material dhe punimi i pritave të lumit (kaskadave). Pritat punohen nga trarët e betonit me dimensione h/b=50/30(50) cm dhe themele h/b=50/100 cm. i armuar me armaturë Ø12 mm, stafa Ø 8mm/20cm duke llogaritur dhe kallupimin.	m'	25,00	160,00	4.000,00 €
2	Punët e trotuarit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e rërës 10-20 mm, d=5cm (në gjendje të ngjeshur)	m³	189,87	18,00	3.417,66 €
2	Furnizimi dhe montimi i gurëve skajor nga betoni 8/20 cm, te klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin)	m²	1.535,50	10,00	15.355,00 €
3	Furnizimi dhe montimi i kubëzave nga betoni me trashësi t=6cm dhe me ngjyrë (dizajni sipas Investitorit) për trotuare përgjatë lumit me sipërfaqe të përpunuar. Kubëzat duhet të jenë të klasës C-30/37	m²	3.538,50	13,00	46.000,50 €
4	Furnizimi dhe vendosja ne veper e betonit C-25/30 për betonimin e traut shtangues me dimensione axb=25x40cm e paraqitur në pjesën grafike, duke e llogaritur armimin minimum 4 Ø12 mm, stafa Ø 8mm/25cm dhe kallupimin.	m³	115,50	120,00	13.860,00 €
Gjithsej totali me TVSH					82.633,16 €
VI	Punët e Metalike				
1	Furnizimi dhe vendosja e gardhit metalik me lartësi h=110 cm, te punohen nga profilet metalike tub Ø75mm me trashësi t=4mm përgjatë lumit, për shkalla dhe rampa sipas profileve karakteristike. Në pozicion të përfshihen edhe ankerat dhe ngjyrosja për mbrojtje nga korrozioni.	m²	1.510,00	20,00	30.200,00 €

1. P. F. - *P. F.*
2. P. M. - *P. M.*
3. L. O. - *L. O.*

Gjithsej totali me TVSH					30.200,00 €
VII	Punët Tjera				
1	Punët e objekteve				
1,1	Furnizimi dhe vendosja e ulëseve përkaj shetitorës. Ulëset duhet të jene me konstruksion nga druri i ipregnuar rezistent ndaj kushteve atmosferike, ndërsa konstruksioni i ulëseve nga hekuri jo i korrodueshëm. Në këtë pozicion llogaritet edhe realizimi i bazës nga beton-armea dhe ankerimi i tyre.	copë	30,00	110,00	3.300,00 €
1,2	Furnizimi dhe vendosja e shportave për mbeturina. Shportat për mbeturina duhet të jenë nga druri rezistent ndaj kushteve atmosferike, ndërsa kapaku dhe pjesa e poshtme nga hekuri jo i korrodueshëm. Diametri i shportave të jetë 40 cm dhe lartësia 65 cm. Në këtë pozicion llogaritet edhe realizimi i bazës nga beton-armea dhe ankerimi i tyre.	copë	30,00	90,00	2.700,00 €
1,3	Furnizimi dhe mbjellja e fidaneve të drunjëve dekorativ. Në këtë pozicion përfshihet hapja e gropës, mbjellja e fidaneve, mbulimi me dhe, pleherimi si dhe punimi i rrethojë rreth bazës së fidanit. Lloji i drurit përcaktohet nga investitori. Lartësia minimale e fidanit duhet të jetë 2m. Drunjët të mbillen çdo 4 m	copë	378,00	15,00	5.670,00 €
1,4	Tabelat informuese me informata për lumin.	copë	2,00	350,00	700,00 €
Gjithsej totali me TVSH					12.370,00 €
VIII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				
1	Testimet e Ngjeshmërisë	komplet	1,00	250,00	250,00 €
2	Testimet e gurëve skajorë dhe kubëzave	komplet	1,00	120,00	120,00 €
3	Testimet e Betonit	komplet	1,00	250,00	250,00 €
Gjithsej totali me TVSH					620,00 €

Rekapitulimi		
I	Punët Pregaditore	47.033,00 €
II	Punët e Dheut	49.160,35 €
III	Punët e Objekteve	301.976,46 €
IV	Punët e Zhavorit	26.932,87 €
V	Punët e Betonit (Guret Skajor dhe Kubzat)	82.633,16 €
VI	Punët e Metalike-Parmaket	30.200,00 €
VII	Punët Tjera	12.370,00 €

1. P.F. - *Shulay*

2. P.M. - *P.M.*

3. L.O. - *L.O.*

VIII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	620,00 €
Gjithsej totali me TVSH		550.925,83 €

Ri-projektimi i rregullimit të shtratit të lumit Llukac - Segmenti I, Gjakove					
Dega 1: L1=0+167.29 km (Pjesa e riprojektuar)					
Dega 2: L1=0+176.09 km (Pjesa e riprojektuar)					
Dega 1: st: 0+167.29 km - 0+787.04 km, L1=0+619.75 km (Gjendja e ekzekutuar që do t'i ndërrohet gypi i kolektorit)					
Dega 2: st: 0+176.09 km - 0+751.09 km, L2=0+575.00 km (Gjendja ekzistuese)					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët pregaditore				
1	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet. Në teren duhet të bëhet piketimi i të gjitha pushtave sipas projektit dhe përcjellja e punimeve gjatë ekzekutimit. Në llogari është marrë gjatësia e trasës nëpër të cilën kalojnë gypat.	m'	963,13	1,50	1.444,70 €
2	Ruajtja e instalimeve nëntokësore gjatë realizimit të punimeve. Vërejtje: Para fillimit të punimeve, të merren informata nga Investitori - Komuna e Gjakovës	m'	963,13	0,50	481,57 €
3	Largimi i ujit gjatë realizimit të punëve	m'	963,13	10,00	9.631,30 €
4	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar. Në projekt duhet të paraqitet gjendja reale pas ekzekutimit me të gjitha ndryshimet eventuale gjatë ekzekutimit (në rast se projekti ka ndryshime).	m'	1.538,13	1,50	2.307,20 €
5	Demolimi i gypit PEHD 630 mm për degën 1 (kanalizimi fekal i ekzekutuar) dhe transporti i tij në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi deri në 15 km.	m'	619,75	6,00	3.718,50 €
6	Demolimi i gypave nga betoni i armuar i pushtave Ø 1000/1000 mm (elemente të parafabrikuara) dhe transporti i tij në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi deri në 15 km.	m'	37,50	55,00	2.062,50 €
7	Demolimi i kinetave dhe bazave të pushtave për degën 1 (kanalizimi fekal i ekzekutuar)	copë	25,00	25,00	625,00 €
8	Demolimi i konuseve për puseta prej betonit-armuar Ø 600/1000/500 mm (elemente të parafabrikuara) dhe transporti i tyre në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi deri në 15 km.	copë	25,00	25,00	625,00 €
9	Demolimi i kapakëve nga betoni i armuar dhe transporti i tyre në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi deri në 15 km.	copë	25,00	25,00	625,00 €

KOM
ORE
1112
GUA

1. P. F. - *[Signature]*

2. P. M. - *[Signature]*

3. L. O. - *[Signature]*

Gjithsej totali me TVSH					21.520,76 €
II	Punët tokësore				
1	Gërmimi i kanalit për kolektorin përkatës, kat. III-IV me gjerësi b=130 të paraqitur për degët 1, 2 dhe b = 80 cm për gypat ndihmës të kanalizimit fekal, sipas profileve karakteristike, dhe transporti i dheut të gërmuar në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi deri në 15 km. Në llogari përfshihet edhe sasia e gërmimit për gypat ndihmës PEHD SN8 250 mm.				
1,1	Gërmimi me makinë 90 %	m³	3.763,15	2,50	9.407,88 €
1,2	Gërmimi me dorë 10 %	m³	376,31	3,00	1.128,93 €
2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm dhe ngjeshja e fundit të kanalit	m²	1.600,00	1,00	1.600,00 €
3	Furnizimi me material dhe sigurimi i kanalit ndaj shembjes së dheut	m²	5.493,52	3,00	16.480,56 €
4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rrerës 0-16 mm në fundin e kanalit anash dhe mbi tub dhe ngjeshja (10 cm rrerë vendosën nën gyp dhe 15 cm mbi gyp). Në llogari është përfshirë edhe sasia e rrerës për mbulimin e gypave ndihmës OD 250 mm.	m³	930,50	10,00	9.305,00 €
5	Furnizimi dhe vendosja e shiritit paralajmërues, i cili vendoset 40 cm mbi gyp	m	963,13	1,00	963,13 €
6	Kthimi i dheut të gërmuar përsëri në kanal, i cili i plotëson kriteret për mbushje deri në shtresat e sipërme të terrenit apo shtresave të rrugës, duke e ngjeshur në shtresa çdo 30 cm.	m³	575,33	5,00	2.876,65 €
7	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushës prej nivelit të rrerës deri te shtresat e terrenit apo të trotuarit me kubëza, duke e ngjeshur në shtresa çdo 30 cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa.	m³	1.500,00	11,00	16.500,00 €
8	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit 0-63 mm nën pllakën e poshte të pusetave, me trashësi t=20 cm.	m³	25,20	17,00	428,40 €
9	Lidhja e kolektorëve të riprojektuar të lumit Llukac - segmenti I me kolektorët e realizuar të segmentit I Duke llogaritet të gjitha punet e nevojshme	copë	3,00	400,00	1.200,00 €
Gjithsej totali me TVSH					59.890,55 €
III	Punët montuese				
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8				
1,1	SN8 Ø 250 mm për lidhjet e reja që do të bëhen në të ardhmen nga pusetat ndihmëse në kolektorët e lumit Llukac. Gjatësia mesatare e gypave për kyçje është 20m	m	240,00	12,00	2.880,00 €

ANI B.
NK
726
JVE

1. P.F. - *[Signature]*

2. P.M. - *[Signature]*

3. L.O. - *[Signature]*

1,2	SN8 Ø 630 mm	m'	178,00	70,00	12.460,00 €
1,3	SN8 Ø 800 mm	m'	790,00	80,00	63.200,00 €
2	Sigurimi dhe montimi i shkallëve nga materiali jo korrodues çdo 30 cm sipas detalit në projekt.	copë	350,00	5,00	1.750,00 €
Gjithsej totali me TVSH					80.290,00 €
IV	Punët e betonit dhe armaturës				
1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit C20/25 për pllakën e poshtme për puseta, d=20 cm (duke e llogaritur edhe një rrjetë armatur Q-335)	m³	25,20	75,00	1.890,00 €
2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit C20/25 për kinetat e pusetave më përpunim sipas detalit, t=10 cm	m³	12,44	75,00	933,00 €
3	Furnizimi transporti dhe montimi i gypave prej betonit të armuar (për puseta) Ø 1000/1000 mm (elemente të parafabrikuara)	m'	18,00	70,00	1.260,00 €
4	Furnizimi transporti dhe montimi i gypave prej betonit të armuar (për puseta) Ø 1200/1000 mm (elemente të parafabrikuara)	m'	43,00	60,00	2.580,00 €
5	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i konuseve për puseta prej betonit-armuar Ø 600/1000/500 mm (elemente të parafabrikuara)	copë	57,00	60,00	3.420,00 €
6	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i konuseve për puseta prej betonit-armuar Ø 600/1200/500 mm (elemente të parafabrikuara)	copë	8,00	80,00	640,00 €
7	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i pusetave hermetike nga betoni i armuar joujëpërshkues për rastin e pusetave të cilat gjenden në lum, të paraqitura në pjesën grafike.	copë	4,00	500,00	2.000,00 €
8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit C25/30 i papërshkueshëm nga uji, t= 20 cm, për segmentet e gypave që kalojnë nëpër shtrat të lumit. Këto segmente gjenden në fillim të urës së rrugës "Behije Dashi" sipas detalit në pjesën grafike. Duke e llogaritur edhe një rrjetë armatur Q-335.	m³	50,74	150,00	7.611,00 €
9	Realizimi i kyqjeve të objekteve në rrjetin e kanalizimit. Gjatësia mesatare e kyqjeve është (10-20) m'. Në këtë pozicion të parashihen të gjitha punët për realizimin e kyqjes.	copë	30,00	150,00	4.500,00
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i pusetave ndihmëse fekale me gypa prej betonit të armuar (për puseta) Ø 1000/1000 mm për lidhjen e kanalizimeve ekzistuese apo të ardhshme të cilat pastaj mund të lidhen në kanalizimin e lumit Llukac, duke i përfshirë të gjitha elementet përcjellëse të tyre si kapakët për pesha të mesme deri në 25 toN të klasës C250 sipas EN 124, kinetat dhe konuset.	copë	12,00	80,00	960,00

1. P.F. - *Phelmy?*

2. P.M. - *Phelmy*

3. L.O. - *Lukac*

11	Furnizimi, transporti dhe montimi i pusetave ndihmëse atmosferike me gypa prej betonit të armuar (për puseta) Ø 1000/1000 mm për lidhjen e kanalizimeve ekzistuese apo të ardhshme të cilat pastaj mund të shkarkohen në shtratin e lumit Llukac, duke i përfshirë të gjitha elementet përcjellëse të tyre si kapakët për pesha të mesme deri në 25 ton të klasës C250 sipas EN 124, kinetat dhe konuset.	copë	4,00	80,00	320,00
12	Furnizimi dhe montimi i kapakëve nga materiali i gizës apo materiali kompozit të klasës C250 sipas EN 124 për pesha të mesme deri në 25 ton. Në çmim të llogaritit edhe rregullimi i kokës së pusetës me beton C-25/30 dhe një rrjetë armaturë Q-335	copë	65,00	89,00	5.785,00 €
13	Furnizimi, transporti dhe montimi i lesheve nga betoni D = 1000 mm (2 copë) duke llogaritur edhe rregullimin e kokës së zbrazjes në lum	m	20,00	100,00	2.000,00 €
Gjithsej totali me TVSH					33.899,00 €
V	Punët tjera				
1	Testimi i rrjetit të kanalizimit, dhe dorëzimi i elaboratit nga një kompani e licencuar	m'	1538,13	1,50	2.307,20 €
2	Pastrimi i terenit pas perfundimit të punimeve, dhe kthimi në gjendjen fillestare.	m'	1538,13	3,00	4.614,39 €
Gjithsej totali me TVSH					6.921,59 €

Rekapitulimi		
I	Punët pregaditore	21.520,76 €
